

**LIGJ**  
**Nr. 7/2023**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,  
NJËRA PALË, DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PALA TJETËR, PËR PJESËMARRJEN E  
SHQIPËRISË NË MEKANIZMIN E MBROJTJES CIVILE TË BASHKIMIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë, njëra palë, dhe Bashkimit Evropian, pala tjetër, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit<sup>1</sup>, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 2.2.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 26, datë 15.2.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bajram Begaj**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NJËRA PALË DHE BASHKIMIT EVROPIAN,  
PALA TJETËR, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MEKANIZMIN E  
MBROJTJES CIVILE TË BASHKIMIT**

Republika e Shqipërisë (në vijim referuar si “Shqipëria”), njëra palë, dhe Komisioni Evropian (në vijim i referuar si “Komisioni”), në emër të Bashkimit Evropian, pala tjetër, në vijim të referuara individualisht si “Pala” dhe së bashku si “Palët”,

*Duke pasur parasysh se* Marrëveshja e Stabilizim-Asociimi ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve anëtare të tyre, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, është miraturar me vendimin e Këshillit dhe Komisionit 2009/332/KE, Euratom<sup>1</sup>

*Duke pasur parasysh se* neni 129 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikon që Marrëveshja Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programet e Komunitetit, nënshkruar më 22 nëntor 2004 (në vijim e referuar si “Marrëveshja Kuadër”)<sup>2</sup>, dhe shtojca e saj do të jetë pjesë përbërëse e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

---

<sup>1</sup> Vendim i Këshillit dhe Komisionit, i datës 26 shkurt 2009, për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve të tyre Anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër (Fletorja Zyrtare e BE-së, L 165, 28.4.2009, f. 165–165).

<sup>2</sup> Marrëveshja kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit (Fletorja Zyrtare e BE-së, L 192, 22.7.2005, f. 2–3).

*Duke pasur parasysh se “Marrëveshja Kuadër”* parashikon në nenin 5 të saj se termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar të pagueshëm, në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në çdo program të veçantë do të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Komisionit dhe Shqipërisë.

*Duke pasur parasysh se* neni 28, pika 1, germa “b”, e vendimit nr. 1313/2013/BE<sup>3</sup>, parashikon që Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të Bashkimit të jetë i hapur për pjesëmarrjen e parimet e përgjithshme dhe termat dhe kushtet e përgjithshme për pjesëmarrjen e këtyre vendeve në programet e Bashkimit të përcaktuara në marrëveshjet kuadër përkatëse dhe vendimet e Këshillit të Asociimit ose marrëveshje të ngjashme,

kanë rënë dakord si më poshtë:

## Neni 1 **Fushëveprimi**

1. Shqipëria do të marrë pjesë si vend dhe do të kontribuojë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit (UCPM) sipas parashikimit në vendimin nr. 1313/2013/BE në versionin e tij më të përditësuar.

2. Në përputhje me nenin 1, të vendimit nr. 1313/2013/BE, pjesëmarrja e Shqipërisë në UCPM synon të forcojë bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian (në vijim i referuar si “Bashkimi”) dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit dhe për të lehtësuar koordinimin në fushën e mbrojtjes civile, me qëllim përmirësimin e efektivitetit të sistemeve për parandalimin, përgatitjen dhe reagimin ndaj fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu.

## Neni 2 **Termat dhe kushtet në lidhje me pjesëmarrjen në mekanizëm**

1. Shqipëria do të marrë pjesë në UCPM dhe aktivitetet e saj në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet komunitare, nënshkruar më 22 nëntor 2004 (në vijim referuar si “Marrëveshja Kuadër”), dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe në vendimin nr. 1313/2013/BE, në versionet e tyre më të përditësuara.

2. Termat dhe kushtet e zbatueshme për paraqitjen, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve nga institucionet, organizatat dhe individët e kualifikuar nga Shqipëria do të jenë të njëjta me ato të zbatueshme për institucionet, organizatat dhe individët e pranueshëm nga Shtetet Anëtare të Bashkimit, përfshirë respektimin e masat kufizuese të Bashkimit.<sup>4</sup>

3. Përfaqësuesit e Shqipërisë kanë të drejtë të marrin pjesë si vëzhgues në komitetin e përmendur në nenin 33, të vendimit nr. 1313/2013/BE, pa të drejtë vote dhe për pikat e rendit të ditës që lidhen me Shqipërinë.

4. Për procedurat që lidhen me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera, administrative të UCPM-së do të përdoret gjuha angleze.

## Neni 3 **Kontributi financiar**

1. Pjesëmarrja e Shqipërisë ose e subjekteve juridike të Shqipërisë në UCPM do t'i nënshtrohet kontributit financiar të Shqipërisë në UCPM dhe kostot përkatëse të menaxhimit, ekzekutimit dhe funksionimit, në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit (në vijim referuar si “buxheti i Bashkimit”).

2. Kontributi financiar do të marrë formën e shumës së:

---

<sup>3</sup> Vendimi nr. 1313/2013/BE i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit, i datës 17 dhjetor 2013, për mekanizmin e mbrojtjes civile të bashkimit (Fletorja Zyrtare e BE-së L 347, 20.12.2013, f. 924).

<sup>4</sup> Masat kufizuese të BE-së miratohen në bazë të Traktatit për Bashkimin Evropian ose Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

- a) një kontributi operacional; dhe
- b) një tarife pjesëmarrjeje.

3. Kontributi financiar do të jetë në formën e pagesës vjetore me një këst dhe, në përputhje me kërkesën për thirrjen për fonde duhet të paguhet jo më vonë se 90 ditë pas datës së thirrjes.

4. Kontributi operacional duhet të mbulojë shpenzimet operative dhe mbështetëse të UCPM-së dhe do të jetë shtesë si në ndarjet e fondeve të angazhuara ashtu edhe në pagesat ndaj shumave të regjistruara në buxhetin e Bashkimit të miratuara përfundimisht për UCPM-në.

5. Kontributi operacional bazohet në një çelës kontributi të përcaktuar si raporti i produktit të brendshëm bruto (PBB) të Shqipërisë me çmimet e tregut ndaj PBB-së së Bashkimit me çmimet e tregut. PBB-të me çmimet e tregut që do të aplikohen do të përcaktohen nga shërbimet e dedikuara të Komisionit bazuar në të dhënat më të fundit statistikore të disponueshme për llogaritjet e buxhetit në vitin para vitit në të cilin duhet kryer pagesa vjetore. Rregullimet për këtë çelës kontributi do të përcaktohen në shtojcën I.

6. Kontributi operacional do të llogaritet duke aplikuar çelësin e kontributit, të rregulluar, në ndarjet fillestare të angazhimeve të regjistruara në buxhetin e Bashkimit të miratuara përfundimisht për vitin e zbatueshëm për financimin e UCPM-së.

7. Tarifa e pjesëmarrjes do të jetë 4% e kontributit operativ vjetor të llogaritur në përputhje me paragrafët 5 dhe 6, të këtij neni dhe do të zbatohet në faza siç përcaktohet në shtojcën I. Tarifa e pjesëmarrjes nuk do t'i nënshtrohet rregullimeve ose korrigjimeve retrospektive.

8. Bashkimi do t'i ofrojë Shqipërisë informacion në lidhje me pjesëmarrjen e saj financiare siç përfshihet në informacionin buxhetor, kontabël, të performancës dhe vlerësimit që iu jepet autoriteteve buxhetore dhe miratuese të Bashkimit në lidhje me UCPM-në. Ky informacion jepet duke pasur parasysh rregullat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave të Bashkimit dhe të Shqipërisë dhe nuk cenon informacionin që Shqipëria ka të drejtë të marrë sipas shtojcës II.

9. Të gjitha kontributet e Shqipërisë ose pagesat nga Bashkimi, si dhe llogaritja e shumave që do të duhet të paguhet ose të atyre që do të merren janë në euro.

#### Neni 4

### **Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi**

1. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit, Zyrës Evropiane kundër Mashtimit (OLAF) dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e UCPM-së, pjesëmarrja e Shqipërisë në UCPM do të monitorohet vazhdimisht mbi një bazë partneriteti, duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë.

2. Rregullat në lidhje me menaxhimin e rregullt financiar, përfshirë kontrollin financiar, rikuperimin dhe masat e tjera kundër mashtimit në lidhje me financimin e Bashkimit sipas kësaj Marrëveshjeje, përcaktohen në shtojcën II.

#### Neni 5

### **Dispozitat përfundimtare**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga 1 janari 2023 dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

3. Bashkimi dhe Shqipëria mund ta zbatojnë këtë Marrëveshje përkohësisht në përputhje me procedurat dhe legjislacionin e tyre të brendshëm përkatës. Zbatimi i përkohshëm do të fillojë në datën kur Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

4. Nëse Shqipëria njofton Komisionin se nuk do të përfundojë procedurat e saj të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të pushojë së zbatuari në mënyrë të përkohshme në datën e marrjes së këtij njoftimi nga Komisioni, e cila do të përbëjë datën e ndërprerjes për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

5. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje mund të pezullohet nga Bashkimi në rast të mospagesës së pjesshme ose të plotë të kontributit financiar që i takon Shqipërisë sipas kësaj Marrëveshjeje.

Në rast të mospagesës, e cila mund të rrezikojë ndjeshëm zbatimin dhe menaxhimin e UCPM-së, Komisioni dërgon një letër zyrtare përkujtuese. Në rast se nuk bëhet asnjë pagesë brenda 20 ditëve pune pas letrës zyrtare të kujtesës, Komisioni i njofton pezullimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Shqipërisë me anë të një letre zyrtare njoftimi, e cila hyn në fuqi 15 ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga Shqipëria.

Në rast se zbatimi i kësaj Marrëveshjeje pezullohet, personat juridikë të vendosur në Shqipëri nuk do të kenë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e dhënies së kontratës ende në proces kur pezullimi hyn në fuqi. Procedura e dhënies së kontratës do të konsiderohet e përfunduar kur si rezultat i kësaj procedure janë marrë angazhime ligjore.

Pezullimi nuk cenon angazhimet ligjore të lidhura me personat juridikë të vendosur në Shqipëri përpara hyrjes në fuqi të pezullimit. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të zbatohet për këto angazhime ligjore.

Bashkimi do të njoftojë menjëherë Shqipërinë me marrjen nga Bashkimi e të gjithë shumës së kontributit financiar që duhet paguar. Pezullimi hiqet me efekt të menjëhershëm pas këtij njoftimi.

Që nga data e heqjes së pezullimit, subjektet juridike të Shqipërisë do të jenë sërish të pranueshëm në procedurat e dhënies së kontratës të nisura pas kësaj date dhe në procedurat e dhënies së kontratës të nisura përpara kësaj date, për të cilat nuk kanë skaduar ende afatet për paraqitjen e aplikimeve.

6. Secila Palë mund ta ndërpresë Marrëveshjen në çdo kohë me një njoftim me shkrim duke informuar Palën tjetër për qëllimin e saj për ta ndërprerë atë. Ndërprerja do të hyjë në fuqi tre muaj kalendarikë pas datës në të cilën njoftimi me shkrim i arrin marrësit. Data në të cilën ndërprerja hyn në fuqi do të përbëjë datën e ndërprerjes për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

7. Kur kjo Marrëveshje pushon së zbatuari të përkohshëm në përputhje me paragrafin 4 ose ndërpritet në përputhje me paragrafin 6, Palët do të bien dakord, që:

a) projektet dhe aktivitetet në lidhje me të cilat janë marrë angazhime ligjore gjatë zbatimit të përkohshëm dhe/ose pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, dhe përpara se kjo Marrëveshje të pushojë së zbatuari ose të ndërpritet, do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

b) kontributi financiar vjetor i vitit “N” gjatë të cilit kjo Marrëveshje pushon së zbatuari përkohësisht ose ndërpritet do të paguhet në përputhje me nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Palët do të zgjidhin me pëlqimin e përbashkët çdo pasojë tjetër të përfundimit ose ndërprerjes së zbatimit të përkohshëm të kësaj Marrëveshjeje.

8. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e përbashkët të Palëve.

Hyrja në fuqi e ndryshimeve do të ndjekë të njëjtën procedurë si ajo e zbatueshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

9. Shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

10. Kjo Marrëveshje do të hartohet në dy kopje në shqip dhe anglisht, ku secili tekst është njëlloj autentik. Në rast të mospërputhjes në interpretim, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

Nënshkruar në Tiranë, më datë 18 nëntor të vitit 2022.

Për Republikën e Shqipërisë

**Niko Peleshi**

Ministër i Mbrojtjes

Për Bashkimin Evropian

**Janez Lenarčič**

Komisioneri për Ndihamat Humanitare dhe menaxhimin e krizave

SHTOJCA I *Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit*

SHTOJCA II *Menaxhimi i rregullt financiar*

SHTOJCA I  
RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË  
MEKANIZMIN E MBROJTJES CIVILE TË BASHKIMIT

**I. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë**

1. Kontributi financiar i Shqipërisë në Mekanizëm do të vendoset mbi baza vjetore në përpjesëtim me, dhe si shtesë, me shumën e disponueshme çdo vit në buxhetin e Bashkimit për ndarjet e angazhuara buxhetore të nevojshme për menaxhimin, ekzekutimin dhe funksionimin e Mekanizmit.

2. Tarifa e pjesëmarrjes e përmendur në nenin 3, paragrafi 7, të kësaj Marrëveshjeje, do të ndahet si më poshtë:

- 2023: 1,5%;
- 2024: 2%;
- 2025: 2,5%;
- 2026: 3%;
- që nga viti 2027: 4%.

3. Në përputhje me nenin 3, paragrafi 5 i kësaj Marrëveshjeje, kontributi fillestar operacional që duhet paguar nga Shqipëria për pjesëmarrjen e saj në Mekanizëm do të llogaritet për vitet financiare përkatëse duke aplikuar një rregullim në çelësin e kontributit. Rregullimi i çelësit të kontributit do të jetë:

Çelësi i kontributit i rregulluar = Çelësi i kontributit x Koeficienti

Koeficienti i përdorur për llogaritjen e mësipërme për të rregulluar çelësin e kontributit, do të jetë 0.3.

Ky rregullim do të zbatohet për kohëzgjatjen e Kuadrit Financiar Shumëvjeçar (2021–2027). Pas përfundimit të periudhës së referuar 7-vjeçare, një ndryshim që detajon rregullimin e kontributit financiar bazë për periudhën pasuese do të përmbillet nga Palët.

**II. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë**

Komisioni do t'i komunikojë Shqipërisë, sa më shpejt të jetë e mundur dhe si afat të fundit kur nxjerr thirrjen e parë për fonde të vitit financiar, informacionin e mëposhtëm:

a) shumat në ndarjet e angazhimeve në buxhetin e Bashkimit, të miratuara përfundimisht për vitin në fjalë për linjat buxhetore që mbulojnë pjesëmarrjen e Shqipërisë, në Mekanizëm;

b) shuma e tarifës së pjesëmarrjes të përmendur në nenin 3, paragrafi 7, të kësaj Marrëveshjeje.

Në bazë të projektbuxhetit të tij, Komisioni do të japë një vlerësim të informacionit për vitin pasardhës sipas pikave “a” dhe “b” sa më shpejt të jetë e mundur, dhe si afat të fundit deri më 1 shtator të vitit financiar.

c) Komisioni do të nxjerrë, si afat të fundit në mars të çdo viti financiar, një thirrje për fonde për Shqipërinë që korrespondon me kontributin e vet sipas kësaj Marrëveshjeje.

Çdo thirrje për fonde do të parashikojë pagesën e kontributit të Shqipërisë jo më vonë se 90 ditë pas shpalljes së thirrjes për fonde.

Shqipëria do të paguajë kontributin e saj financiar sipas kësaj Marrëveshjeje në përputhje me pikën II të kësaj shtojce. Në mungesë të pagesës nga Shqipëria deri në datën e caktuar, Komisioni do të dërgojë një letër zyrtare kujtese.

Çdo vonesë në pagesën e kontributit financiar do të shkaktojë pagesën e interesit të kamatëvonesës nga Shqipëria mbi shumën e papaguar nga data në të cilën duhej kryer pagesa.

Norma e interesit për shumat e arkëtueshme të papaguara në datën e caktuar do të jetë norma e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, publikuar në serinë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie afati i pagesës, e rritur me tri pikë e gjysmë përqindjeje.

SHTOJCA II  
MENAXHIMI I RREGULLT FINANCIAR, MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARE DHE  
RIKUPERIMI

**I. Rishikimet dhe auditimet**

1. Bashkimi Evropian ka të drejtë të kryejë, në përputhje me aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Bashkimit dhe siç parashikohet në marrëveshjet dhe/ose kontratat përkatëse, rishikime dhe auditime teknike, shkencore, financiare ose lloje të tjera në ambientet e çdo personi fizik rezident ose çdo personi juridik të vendosur në Shqipëri dhe që merr fonde nga Bashkimi Evropian, si dhe çdo palë e tretë e përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit me banim ose të vendosur në Shqipëri. Rishikimi dhe auditimet mund të kryhen nga agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, ose nga persona të tjerë të mandatuara nga Komisioni Evropian.

2. Agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, dhe personat e tjerë të mandatuara nga Komisioni Evropian, do të kenë akses të duhur në vendet, punët dhe dokumentet (si në versionet elektronike dhe në letër) dhe të gjithë informacionin e kërkuar për të kryer këto auditime, përfshirë të drejtën për të marrë një kopje fizike/elektronike dhe ekstrakte; të çdo dokumenti ose përmbajtjen e çdo mediumi të dhënash të mbajtur nga personi fizik ose person juridik i audituar, ose nga pala e tretë e audituar.

3. Shqipëria nuk do të parandalojë ose ngrëjë pengesë të veçantë për të drejtën e hyrjes në Shqipëri dhe për hyrjen në ambientet të agjentëve dhe personave të tjerë të përmendur në paragrafin 2, për arsye të ushtrimit të detyrave të tyre të përmendura në këtë nen.

4. Rishikimet dhe kontrollet mund të kryhen, gjithashtu pas pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 5 të saj, përfundimit të zbatimit të përkohshëm ose ndërprerjes së saj, në kushtet e përcaktuara në aktet në fuqi të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Bashkimit Evropian, siç parashikohet në marrëveshjet dhe/ose kontratat përkatëse në lidhje me çdo angazhim ligjor që zbaton buxhetin e Bashkimit Evropian të lidhur nga Bashkimi Evropian përpara datës së hyrjes në fuqi të pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 5 të saj, përfundimit të zbatimit të përkohshëm ose ndërprerjes së kësaj Marrëveshjeje.

## **II. Lufta kundër parregullsive, mashtrimeve dhe veprave të tjera penale që cenojnë interesat financiare të Bashkimit**

1. Komisioni Evropian dhe Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) autorizohen të kryejnë hetime administrative, duke përfshirë kontrolle dhe inspektime në vend, në territorin e Shqipërisë. Këto hetime kryhen në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara nga aktet në fuqi të një ose më shumë institucioneve të Bashkimit.

2. Autoritetet kompetente të Shqipërisë informojnë Komisionin Evropian ose OLAF-in brenda një kohe të arsyeshme për çdo fakt ose dyshim që u është sjellë në vëmendje në lidhje me parregullsitë, mashtrimet ose aktivitetet e tjera të paligjshme që cenojnë interesat financiare të Bashkimit.

3. Kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen në ambientet e çdo personi fizik që banon ose person juridik i themeluar në Shqipëri dhe merr fondet e Bashkimit, si dhe të çdo pale të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit që banojnë ose vendosen në Shqipëri.

4. Kontrollet dhe inspektimet në vend përgatiten dhe kryhen nga Komisioni Evropian ose OLAF-i në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin kompetent në Shqipëri të caktuar nga Shqipëria. Autoritetit të caktuar duhet t'i njoftohet një kohë e arsyeshme paraprakisht për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të mund të ofrojë ndihmë. Për këtë qëllim, zyrtarët e autoriteteve kompetente të Shqipërisë mund të marrin pjesë në kontrollet dhe inspektimet në vend.

5. Me kërkesë të autoriteteve të Shqipërisë, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen së bashku me Komisionin Evropian ose OLAF-in.

6. Agjentët e Komisionit dhe stafi i OLAF-it do të kenë akses në të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, përfshirë të dhënat kompjuterike, mbi operacionet në fjalë, të cilat kërkohen për kryerjen e duhur të kontrolleve dhe inspektimeve në vend. Në veçanti, mund të fotokopjojnë dokumentet përkatëse.

7. Kur personi, subjekti ose një palë tjetër e tretë i reziston një kontrolli ose inspektimi në vend, autoritetet e Shqipërisë, duke vepruar në përputhje me rregullat dhe rregulloret kombëtare, e ndihmojnë Komisionin Evropian ose OLAF-in, për t'i lejuar të përmbushin detyrën e tyre në kryerjen e një kontrolli ose inspektimi në vend. Kjo ndihmë do të përfshijë marrjen e masave të duhura paraprake sipas legjislacionit kombëtar, veçanërisht për të mbrojtur provat.

8. Komisioni Evropian ose OLAF-i informojnë autoritetet e Shqipërisë për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve. Në veçanti, Komisioni Evropian ose OLAF-i i raportojnë sa më shpejt të jetë e mundur autoritetit kompetent të Shqipërisë çdo fakt ose dyshim në lidhje me parregullsi që është sjellë në vëmendjen e tyre gjatë kontrollit ose inspektimit në vend.

9. Pa cenuar zbatimin e së drejtës penale të Shqipërisë, Komisioni Evropian mund të vendosë masa administrative dhe penalitete ndaj personave juridikë ose fizikë të Shqipërisë që marrin pjesë në zbatimin e një programi ose aktiviteti në përputhje me legjislacionin e Bashkimit.

10. Për qëllime të zbatimit të duhur të këtij neni, Komisioni Evropian ose OLAF-i dhe autoritetet kompetente të Shqipërisë shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesë të njëjës prej palëve në këtë Marrëveshje, konsultohen me njëri-tjetrin.

11. Për të lehtësuar bashkëpunimin efektiv dhe shkëmbimin e informacionit me OLAF-in, Shqipëria cakton një pikë kontakti.

12. Informacioni shkëmbehet ndërmjet Komisionit Evropian ose OLAF-it dhe autoriteteve kompetente të Shqipërisë duke respektuar kërkesat e konfidencialitetit. Të dhënat personale të përfshira në shkëmbimin e informacionit, mbrohen në përputhje me rregullat në fuqi.

13. Autoritet e Shqipërisë bashkëpunojnë me Zyrën e Prokurorit Publik Evropian për ta lejuar të përmbushë detyrën e vet për të hetuar, ndjekur penalisht dhe sjellë para drejtësisë autorët dhe bashkëpunorët e veprave penale që cenojnë interesat financiare të Bashkimit Evropian në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **III. Rikuperimi dhe zbatimi**

1. Vendimet e miratuara nga Komisioni Evropian që vendosin një detyrim financiar ndaj personave juridikë ose fizikë të ndryshëm nga shtetet në lidhje me çdo pretendim që rrjedh nga Mekanizmi janë të detyrueshme në Shqipëri. Urdhri për ekzekutim i bashkëlidhet vendimit, pa asnjë formalitet tjetër përveç verifikimit të origjinalitetit të vendimit nga autoriteti kombëtar i caktuar për këtë qëllim nga Shqipëria. Shqipëria do t'i bëjë të njohur autoritetin e caktuar kombëtar Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Në përputhje me nenin 4, të kësaj shtojce, Komisioni Evropian ka të drejtë t'u njoftojë vendimet e detyrueshme drejtpërdrejt personave rezident dhe personave juridikë të vendosur në Shqipëri. Zbatimi kryhet në përputhje me ligjin dhe rregullat e procedurës së Shqipërisë.

2. Vendimet dhe urdhrat e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian të dhëna në zbatim të një klauzole arbitrazhi të përfshirë në një kontratë ose marrëveshje në lidhje me programet, aktivitetet, veprimet ose projektet e Bashkimit do të jenë të zbatueshme në Shqipërisë në të njëjtën mënyrë si vendimet e Komisionit Evropian, të përmendura në pikën 1.

3. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka juridiksion për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të përmendur në pikën 1 dhe për të pezulluar zbatimin e tij. Megjithatë, gjykatat e Shqipërisë kanë juridiksion mbi ankesat se zbatimi po kryhet në mënyrë të parregullt.

### **IV. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit**

Institucionet dhe organet e Bashkimit të përfshira në zbatimin ose kontrollet mbi UCPM-n, kanë të drejtë të komunikojnë drejtpërdrejt, përshtirë edhe sistemet e shkëmbimit elektronik, me çdo person fizik rezident ose person juridik i vendosur në Shqipëri dhe merr fondet e Bashkimit, si dhe çdo palë e tretë e përfshirë në zbatimin e fondeve të Bashkimit rezident ose të vendosur në Shqipëri. Këta persona, subjekte dhe palë mund t'u dorëzojnë drejtpërdrejt institucioneve dhe organeve të Bashkimit të gjithë informacionin dhe dokumentacionin përkatës që u kërkohet të dorëzojnë në bazë të legjislacionit të Bashkimit të zbatueshëm për UCPM-në dhe kontrata ose marrëveshjet e lidhura për zbatimin e UCPM-së.